



## Thirrje për Projekt Propozime në fushën e Turizmit

Një nga aspektet më të rëndësishme të zhvillimit të turizmit në Shqipëri është zgjatja e sezonit turistik. Një turizëm i suksesshëm dhe cilësor sigurisht varet nga tërheqja e tregut për gjatë gjithë vitit. Përqendrim më i madh i turistëve është gjatë sezonit veror dhe në plazhet e vendit por Shqipëria ka nevojë të njihet si një destinacion për t'u vizituar gjatë gjithë vitit duke promovuar destinacionet turistike lokale për të gjallëruar edhe aktivitetet e turistive gjatë verës.

Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, duke inkurajuar zgjerimin e sezonit turistik nëpërmjet diversifikimit të produktit turistik me modele inovative dhe promovimit të tij, si dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimit në plazhet tona. Duke pasur parasysh këto objektiva kryesore, thirrja e këtij viti është e ndarë në tri tematika:

### A. Zhvillimi dhe përmirësimi i produkteve turistike specifike me paketa inovative.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkë financojë projekte që do të synojnë:

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçantë me synim: argëtimin; shkëmbimin e eksperiencës dhe të të nxënit.
- Zhvillimin e produktit turistik duke kombinuar elemente të teknologjisë inovative për njohjen sa më të gjërë të produktit.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i produkteve turistike specifike, në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa turistike lokale, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese.

### B. Promovimi i atraksioneve turistike nëpërmjet aktiviteteve mediatike.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkë financojë projekte që do të synojnë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka turizmi për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme.
- Përfshirjen, gjithnjë e më shumë, të komuniteteve lokale në sektorin e turizmit.
- Zhvillimin e marketingut të brendshëm, me synim lidhjen e industrisë së mikpritjes me industri të tjera lokale.

### C. Ndërgjegjësimit i vazhdueshëm për mbajtjen pastër të plazheve dhe stacioneve të plazheve

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkë financojë projekte që do të synojnë:

- Aksione për ndërgjegjësimin dhe pastrimin e stacioneve të plazhit përpara fillimi të sezonit turistik veror dhe gjatë tij
- Përfshirjen e të komuniteteve lokale në ndërgjegjësimin dhe aksion.
- Monitorim dhe ndërhyrje të vazhdueshme në stacionet e plazheve përgjatë sezonit.